

Antithesis

Buxhovi falsifikon historinë

Nga Albert RAMAJ/ Nuri BEXHETI

Buxhovi, Jusuf, «Kosova – Antika, Mesjeta, Perandoria Osmane, nga Konferenca e Londrës deri në Protektoratin Ndërkombëtar», Shtëpia botuese “Faik Konica & Jalifat Publishing”, Prishtinë/Huston 2012.

Para do kohësh u botua në Prishtinë libri trevëllimësh me titullin “Kosova - Antika, Mesjeta, Perandoria Osmane, nga Konferenca e Londrës deri në Protektoratin ndërkombëtar”, autor i të cilit është Jusuf Buxhovi. Libri në fjalë bëri jehonë të madhe dhe nga një numër i konsiderueshëm i mediave kosovare u prit me pompozitet.

Libri i Buxhovit hyn ndër ata libra që janë pjesë e polemikës historiografike, e cila ka më shumë se njëzet vjet që po përkujdeset gjithandej për trazira dhe thellim armiqësish ndër popujt e Europës juglindore. Është fjala për një polemikë që mund të cilësohet si betejë historianësh në garën e tyre se kush prej tyre do ta gjejë recetën më të mirë për të dëshmuar autoktoninë e këtij ose atij populli. Secili komb, pavarësisht në është “i lashtë” ose “i ri” - në të shumtën e rasteve i përkrahur me subvencione shtetërore ose nga arkat partiake - përpiqet të sjellë argumentin më bindës rreth të drejtës së vetë natyrore për të sunduar mbi toka të caktuara ballkanike. Thënë troç gjithë kjo ka të bëjë me pyetjen: kush ishte i pari këtu?

Brenda hapësirës shqiptare deri më tani ka pasur vetëm disa kritika simbolike rreth “teorisë më të re” të Buxhovit mbi etnogjenezën e shqiptarit të sotëm. Në librat e tij autori u drejton një kritikë të ashpër universiteteve shqiptare dhe institucioneve të tjera arsimore, të cilat, sipas mendimit të tij, janë bërë instrument i historiografisë tendencioze serbo-greke, sidomos për faktin që me injorancën e tyre këto institucione famën antike ua paskëshin lënë pa të drejtë grekëve (Buxhovi, *Kosova*, libri I, f. 270). Me një vetëbindje gati narcisoide gazetari kosovar Jusuf Buxhovi bën thirrje për një historiografi shkencore, të pastër dhe objektive. Historianët e tjerë, ata që etnogjenezën shqiptare e shohin ndryshe prej tij, Buxhovi i difamon si albanofobë.

Por çka nënkupton Buxhovi nën togfjalëshin “historiografi objektive dhe shkencore”?

2

Përse reagojmë ne?

Ne i lexuam me kujdes tri vëllimet e librit “*Kosova...*” të Jusuf Buxhovit. Tezat që paraqet Buxhovi, sikurse që do të shihet më poshtë, nuk janë të reja. Kësisoj përpjekjesh datojnë që nga shekulli XIX - e re është gjeografia e tyre dhe mënyra e interpretimit të tyre. Aty formulohen teza që jo vetëm janë në kundërshtim, por edhe përmbysin gjithë studimet e bëra në dyzet vjetët e fundit mbi Europën Juglindore në hapësirën anglosaksone, gjermanofone dhe frankofone.

Vendosëm të reagojmë ngase ne, fatkeqësisht, na u desh të konstatojmë që Buxhovi jo vetëm keqpërdor burimet në mënyrë dramatike gjatë interpretimit të tyre (si

Ciceroni etj., lexo më poshtë), por shpeshherë ato që ai i paraqet si burime nuk janë fare të tilla dhe janë vetëm riprodhime e interpretime të huaja, të cilave po ashtu u mungojnë burimet parësore.

Autorët e këtij shkrimi nuk mëtojnë të testojnë metodën dekonstruktive të Derrida-së mbi kurrizin e historiografisë shqiptare, por thjesht ndiejnë detyrim të marrin anën për një historiografi objektive dhe të dijës, për një histori “*ad fontes*”, për një histori të burimeve ashtu siç janë edhe atëherë kur ato burime do të thyenin ëndrrat tona romantike duke na përplasur para pasqyrës e duke na dhënë një identitet krejt ndryshe nga ai tek i cili kemi besuar tërë jetës. Jemi të vetëdijshëm se mund të akuzohemi me gjithfarë epitetesh nga ata që janë mësuar ta shkruajnë historinë si ep ose si këngë dasmash folklorike, por për hir të një katarsi të nevojshëm në shoqëritë tona po e marrim parasysh rrezikun e fyerjeve të mundshme dhe bëjmë thirrje për një histori objektive dhe pa urrejtje.

Historia mes të vërtetës dhe falsifikimit

“*Historia magistra vitae*” kështu thoshte Ciceroni në librin e tij të dytë të *Mbi ligjërimin* (Cicero, *De Oratore*, II, 36) dhe vazhdonte: ajo - Historia - është drita e të së vërtetës dhe shkenca e njëmendtë, ngase ajo është “dëshmitare” e kohërave. Por për çfarë i shërbente Ciceronit kjo dëshmitare e kohërave të vjetra? A i shërbente ajo me mitet dhe heronjtë e saj si mjet manipulimi për të liruar klientin e tij, të akuzuarin Sextus Roscius, nga akuza për vrasje? (Cicero, *Pro Quintio*, pass.). Po ashtu bëmat historike të

të shenjtëve, të heronjve dhe mitet Ciceroni i transferonte si vlera të mishëruara në personalitetin e klientit të tij. Masa u hipnotizua. Gjykatësit kishin frikë. Vrasësi u lirua. A e ka rrëfyer Ciceroni historinë në mënyrë objektive? Ndoshta. A e ka falsifikuar ai historinë për të liruar një vrasës? Po. Ai e keqpërdori të kaluarën duke e interpretuar atë qëllimisht në mënyrë për të arsyetuar një veprim të kryer në kohën e tij. Pyetja se a i falsifikoi Ciceroni burimet - duke i paraqitur si fakte ndryshe nga ç'ishin - në këtë kontekst nuk është gjithaq relevante. Me rëndësi në këtë mes është fakti që Ciceroni me ndihmën e Historisë falsifikoi aktualitetin dhe, nëpërmjet këtij falsifikimi, shndërroi një vrasës në fisnik. Ai i mashtroi bashkëkohësit, i verboi ata duke i shndërruar në marioneta të paafta, qenie pa mundësi mendimi të pavarur dhe vetjak. Nëpërmjet autoritetit të tij prej dijetari, siç u tha, për qëllime të ulëta vetjake ai ia rrëmbeu masës të drejtën për racionalitet.

Në vend të Ciceronit marrim historianin dhe eksperimentojmë më tutje. Në vend të historianit ftojmë në skenë Jusuf Buxhovin. Ose ndonjë nga kolegët e tij nga Beogradi, Shkupi, Tirana, Sofja, Zagrebi etj.

Gjatë gërmimeve të tij një arkeolog gjen një shpatë dhe dëshiron ta identifikojë atë si armë të Skënderbeut. Buxhovit i duhet ta kontekstualizojë këtë gjetje dhe të shkruajë historinë. Buxhovi e di që masat heroin kombëtar e nderojnë si Zot dhe duhet të vendosë se si duhet ta shkruajë historinë e shpatës. Shkenca e detyron atë të përdorë sistematikën e Droyzen-it (që nga heuristika deri në interpretimin e ideve). Ai nuk e ka harruar maksimën e Max Weber-it, e cila kërkon prej tij të ndajë botëkuptimin nga

shkenca. Megjithatë është në dilemë. Ai gjendet para katër alternativave:

Alternativa e parë: Ta paraqesë shpatën si armën e një shenjtori dhe heroit të drejtë dhe asgjë më shumë. Rezultati: populli atë e do. Festohet.

Alternativa e dytë: Të qëndrojë objektiv, duke qenë se e do profesionin e historianit, dhe të thotë: Kjo është arma e një burri që nga masa është pranuar si shenjtor, e një trimi që vrau brutalisht shumë njerëz duke mbrojtur vendin e tij. Për disa ai është një shenjtor dhe hero, për të tjerët tradhtar dhe kriminel. Objekti - shpata - i shërbente atij për të vrarë etj. Rezultati: populli atë e urren.

Alternativa e tretë: Ta paraqesë shpatën si armë të një pirati të parëndësishëm nga Karaibet. Rezultati: Ai shpallet i sëmurë psikik.

Alternativa e katërt: Të mos thotë asgjë dhe të merret me tema të tjera të historisë. Rezultati: Askush nuk e di se kush është ai. Jeton në anonimitet.

Para kësaj dileme gjenden plot historianë të Europës Juglindore. E shumta e tyre janë përcaktuar për alternativën e parë. Jusuf Buxhovi po ashtu.

Metoda dhe burimet

Straboni (Στραβων) shndërrohet në Strobanis, Paul Kretschmer në P. Kreschmer (libri 1, f. 35-36), Georg në Gerog (po aty, f. 50), Jens Reuter shndërrohet në Ernst Reuter (libri 3, f. 912), Bartl Peter shndërrohet në Bartel Petr (libri 3, f. 918), Troebst Stefan shndërrohet në Troenst Stafan (libri 3, f. 919), Libal Wolfgang shndërrohet në Libald Wolfgang (libri 3 f. 919), Jokl N. shndërrohet në Jockl N. (libri 2, f. 636), Kraft Ekkehard

shndërrohet në Kraft Ekkerard (libri 3, f. 918), R. Schwanke ripagëzohet në R. Schanke (libri 2, f. 633), Oschlies Wolf merr nofkën Olschli (libri 3, f. 915) dhe kështu deri në pafundësi. Ndërsa sensacioni më i madh është që në librin e tretë të Buxhovit gjen edhe libra që nuk kanë ekzistuar si të tillë. P.sh. një autor me emrin Libald Michael del si autor i studimit “*Der Balkan*”, që qenkësh botuar në München (libri 3, f. 914. Ky autor nuk ekziston fare. Botimi në fjalë po ashtu. E shumta e emrave të autorëve janë ose të shkruar gabim ose bëhen autorë citatesh të huaja (dëshmitë e autorëve antikë paraqiten si rezultate të cituesve paraparakë).

Kapituj të tërë janë pa fusnota (na falni: ai e citon vetveten si burim të vetëm shkencor, ff. 626-670). Kapituj të tjerë janë përkthyer gati fjalë-për-fjalë dhe janë përvetësuar si autorialë. Kështu kapitulli mbi “*Pansllavizmin*”, i cili në mënyrë fragmentare i është rrëmbyer librit “*Ballkani - historia e një qytetërimi*” i autorit amerikan Ferdinand Schevill (1868-1954) (libri 2, ff. 168-175).

Shihet sheshazi se autori përjashton me qëllim të gjitha ato burime, studime, të dhëna arkeologjike dhe literaturë dytësore me rëndësi, që mund të ishin në disfavor të tezave të tij. Para së gjithash në bibliografinë e Buxhovit mungojnë studimet e 30 viteve të fundit. Burimet e pakta janë kryesisht nga autorë dhe rezultate shkencore të viteve 80 të shek. XIX dhe 20 të shek. XX. Përkundër pohimeve se sjellkësh fakte të reja mbi Antikën (kjo edhe është baza e “popullaritetit” të librit të tij), ai nuk thotë asgjë për diskurset aktuale për të ashtuquajturën “çështje homerike” (Vetëm si shembull: Alfred Heubeck, *Die homerische Frage. Ein Bericht über die Forschung der letzten Jahrzehnte*, Darmstadt 1974) dhe “debatin mbi Trojën” (Christoph Ulf (Hrsg.), *Der neue Streit um Troia* -

eine Bilanz, C. H. Beck, München 2003; Gregor Weber, *Neue Kämpfe um Troia. Genese, Entwicklung und Hintergründe einer Kontroverse*, në "Klio" 88, 2006, ff. 7–33; Frank Kolb, *Tatort 'Troia'. Geschichte. Mythen. Politik*, Ferdinand Schöningh, Paderborn - München - Wien - Zürich 2010), edhe pse hipotezat e tij i bazon po në Homerin dhe Trojën.

Si burim kryesor për autorët antikë atij i shërben libri "Studimet shqiptare" (*Albanesische Studien*, Friedrich Mauke, Jena 1854) i juristit gjermano-austriak dhe albanologut Johann Georg von Hahn. (Hahni ishte konsull më 1847 në Janinë, më 1851 në Syra dhe që nga 1869 konsull i përgjithshëm në Athinë; mbahet për themelues të hulumtimeve për Shqipërinë, i cili mblodhi material, mësoi shqipen dhe argumentoi se gjuha shqipe bën pjesë në grupin e familjes së gjuhëve indoevropiane etj.) Me një analizë më të thukët të faqeve 31-121 (libri I), në të cilën autori parashtron tezën e pellazgëve, ne gjejmë ngjashmëri mahnitëse stilistike dhe strukturore me "studimin historik kritik" të Wassa Efendiut (Pashko Vasës) të botuar në vitin 1879 (pra dhjetë vjet pas vdekjes së Hahnit) dhe njohur edhe në gjermanishte në një botim të Berlinit.

Vepra "Çështja pellazge dhe zgjidhshmëria e saj" (*Die Pelasgerfrage und ihre Lösbarkeit*, Franz Fues 1890), me të cilën Ellis Hesselmeier-i është përpjekur në mënyrë të pasuksesshme të sjellë argumentimin gjuhësor e hapësinor mbi ekzistimin e pellazgëve si popull jogrek dhe joilir nuk përmendet askund.

Në njërën anë Buxhovi zhvlerëson me të drejtë historinë zyrtare shqiptare si prodhim i "pseudohistorianëve komunistë", ndërsa në anën tjetër e përdor atë si burim të vetëm për të shkruar historinë e vet. Denoncon historiografinë serbe si të rrejshme, por nuk "shfrytëzon" asnjë burim konkret. Replikon gjithë kohën, pa përmendur burimet

e historiografisë së falsifikuar dhe pa sjellë njoftime se prej nga vijnë hipotezat që ai hedh poshtë.

Teza e Buxhovit mbi pellazgët

Buxhovi injoron rezultatet e vjetra dhe të reja të hulumtimeve linguistike dhe arkeologjike. I merr burimet e Hahn-it (me të gjithë riprodhuesit e tij në hapësirën shqipfolëse) mbi gjenezën pellazge të shqiptarëve një për një dhe i paraqet në një formë shkencore mjaft të dyshueshme si të vetat.

Teza e tij e parë, përmbledhtazi, duket kështu: Dardanët janë si të gjitha - fiset e tjera ilire - pasardhës të pellazgëve. Ata luftuan për shpëtimin e Trojës. Përmes mijëra viteve ata u mbijetuan të gjitha invadimeve të mundshme deri në ditët e sotme, kur Kosova shpalli pavarësinë e saj. Për këtë shkak dhe për arsye të rolit të saj (pellazg) në krijimin e qytetërimit perëndimor Kosova është qendër jo vetëm e historisë shqiptare, por edhe të asaj perëndimore (libri 1, ff. 8-9.).

Faktografia e Buxhovit rreth dëshmisë dhe vijimësisë pellazgo-dardane-shqiptare ka në thelb vetëm një burim: Homerin! Këtë çështje ai e “zgjidh” duke përsëritur për të kushedi-se-satën herë burimet që i kemi lexuar te Hahn-i dhe te “Historia [zyrtare] e Popullit Shqiptar” (libri 1, ff. 13 -19 dhe ff. 31 – 50). E tërë hipoteza konstruktohet gati pa asnjë burim tjetër, si burime paralele shtohen vetëm “Fjalori Mitologjik” dhe 5 vargje të Homerit, ku flitet për Dardanosin (po aty, ff. 121-128.).

Por çka thoshin në fakt Homeri, Hesiodi, Herodoti, Tukididi, Isokrati, Demosteni

etj., të cilët Buxhovi i përdor si burime për të argumentuar tezën se pellazgët janë paraardhës të dardanëve dhe ilirëve (libri 1, ff. 13 -19 dhe ff. 31 – 50)? T'i rilexojmë përqendrueshëm këto burime.

Poetët

a) **Homeri.** Duke lënë anash “çështjen homerike” për të cilën debatojnë shkencëtarët e letërsisë, po analizojmë Homerin jo si poet, por si të ishte burim i besueshëm shkencor. Që do të thotë se ne këtu funksionalizojmë parimin e kontingjencës filozofike: e marrim diçka si të mundshme edhe njëherësh të pamundshme. Në ndihmë thërrasim studimin e profesorit të merituar heidelbergas Armin Wolf, i cili me dhjetëvjeçarë tërë hulumtoi për të rikonstruktuar një gjeografi të saktë të vendeve homerike. Në veprën e tij “Udhëtimi i Homerit - gjurmëve të Odiseut” (Wolf, *Homers Reise*, Köln –Weimar- Wien -Böhlau 2009, ff. 393-409) nuk i hasim vendet e Buxhovit. Në listën e emrave dhe sendeve në fund të librit nuk i gjejmë as ilirët e as dardanët, ndërsa Dardanelet i gjejmë si lokalitet ku ekzistonte Ilioni. Për herë të parë Homerit i paraqet pellazgët si banorë të Arbosit (Homer, *Ilias*, II, v. 681). Njëqind e gjashtëdhjetë rreshta më tutje Homerit thotë:

“Dhe Hipotosi udhëhiqte fiset e mjeshtëurve në gjuatjen e shtizës, pellazgët, banorët e Larisë tmerrmbjellëse” (po aty, II, v 840).

Homerit i paraqet pellazgët si një popull shumëfisnor. Në Këngën e dhjetë i përmend sërish pellazgët fisnikë së bashku me paionët, lelegët, karët dhe kaukonët

(Homer, *Ilias*, X, vv. 426-429). Më vonë në Këngën e gjashtëmbëdhjetë pellazgët kanë edhe Zotin e tyre, Zeusin, i cili jetonte në orakullin Dodonë të Epirit (Homer, *Ilias*, XVI, vv. 233-235). Tek “Odisea” Homeri i gjen pellazgët fisnikë duke banuar së bashku me dorët dhe kidonët në ishullin e Kretës, ku jetonin të përzier shumë “gjuhë dhe popuj” (Homer, *Odyssée*, XIX, vv. 170-178). Pra, sipas Homerit pellazgët ishin njerëz fisnikë, të cilët jetonin gati gjithandej: në Kretë, Epir, Larisë, besonin Zeusin dhe ishin shigjetarë të mrekullueshëm.

Paralelisht Homeri ka edhe një nëntregim, atë të dardanëve. Në Këngën e dytë të *Iliadës* Eneu, i biri i Afroditës, është aleat i Trojës dhe udhëheq dardanët në luftë (Homer, *Ilias*, II, v. 819). Në Këngën e tretë flet Agamemnoni dhe thotë: “...Dëgjoni fjalën time, ju trojanë, ju dardanë dhe miq të tyre” (Homer, *Ilias*, III, v. 456). E njëjta thirrje e Agamemnonit paraqitet edhe në Këngën e shtatë (Homer, *Ilias*, VII, v. 348). Në Këngën e tetë Hektori i këshillon luftëtarët e tij dardanë, trojanë dhe likenas që të luftojnë me trimëri kundër grekëve (Homer, *Ilias*, VIII, v. 173). Homeri pra i paraqet dardanët si pjesë të Trojës (si banorë të qytetit Dardanos, lexo më poshtë Herodotin), d.m.th. si banorë të bashkësisë trojane që shkojnë në luftë për të mbrojtur mbretërinë e tyre nga armiqtë e jashtëm, po si likenasit dhe fiset e tjera që popullonin Trojën e atëhershme. Në dy epet e Homerit nuk ka as edhe një fakt që pellazgët fisnikë të Epirit, Larisë dhe Kretës të mund t’i asocionte, pra t’i vinte në kontekst me dardanët. Meqenëse në botën e Homerit të dyja fiset jetojnë në të njëjtën kohë, në rajone të

ndryshme dhe me karakteristika të ndryshme, do të dilte jashtë logjike tregimi nëse Homeri do t'i paraqiste pellazgët si pasardhës të dardanëve.

b) **Hesiodi** (sipas Strabonit, *Geographica*, 7.7.10) e përsërit atë që thoshte Homeri, përkatësisht: Zeusi ishte Zoti i pellazgëve dhe më tutje plotëson: emrin e tyre pellazgët e morën nga babai i tyre Pellazgos, i cili ishte edhe babai i mbretit Lykaon dhe të atij të Arkadisë (Arkadia shtrihej - hulumtuesit as për këtë nuk janë të një mendjeje - ose në Sicili ose në Peloponez). Pra as nga Hesiodi nuk rezulton asgjë relevante që do të hynte në funksion të sqarimit të çështjes pellazge.

c) **Letrarët e tjerë**: **Eskili** në pjesën e tij mbi Danaidën thotë: Të ikurit nga Egjipti gjetën mbrojtje te mbreti Pellazgos nga Argosi (Aischylos, *The Suppliants*, vv. 249-25t). Sipas tij ky rajon gjendej në Mikenë, në pjesën e Thesalisë. **Sofokliu** i përshkruan tyrsenoi-pellazgët si popullin më të vjetër të vendeve Argos, qendra e të cilëve ishte Larisa (Sophokles, Fragment *Die Männer von Larissa*, ff. 61-64, vv. 157 -58; dhe Fragmenti *Inachos* 347 (243)). **Euripidi** Argosin pellazg e vendos si skenë të tragjedisë së tij *Orestia*. (Euripides, *Orestia*, pass.). Poeti i mëvonshëm romak **Ovidi** i shpall pellazgët si aleatë të grekëve:

*“Paridi nuk ishte aty [...], ai që solli luftën e kobshme në atdheun e tij
Bashkë me femrën e rrëmbyer. Atë e ndiqnin anije të përbetuara, mijëra sish,
Dhe e gjithë bashkësia e fisit pellazg...”*

(Ovidius, *Metamorphosen*, III, vv. 51-56).

Edhe tek Ovidi shihet se Homeri ishte burimi dhe frymëzimi kryesor i poetëve

dhe shkrimtarëve të Antikës dhe pasAntikës. Versioni i tij i historisë mbi pellazgët, aty-këtu me ndonjë ndryshim, tregohet edhe më tutje njëjtë. Më vonë pellazgët gjithnjë më shumë zhduken si motiv nga krijimtaria letrare e kohës.

Historianët dhe Gjeografët

Historiani dhe gjeografi **Hekateu nga Mileti** (560-480 p.e.s.), që merret si historiani i parë i njohur, në veprën e tij *Genealogiai* shkruan dy herë për pellazgët, të cilët i paraqet si “genos”, që do të thotë fis, klan (*Hecateus von Milet von Klausen*, Rudolf Heinrich, Berlin 1831, Fragment 224, f. 140 dhe Klaus Meister: *Die griechische Geschichtsschreibung*, Stuttgart 1990). Në një fragment tjetër ai tregon që Pelasgosi ishte biri i Zeusit dhe Niobes dhe që ai - Pelasgosi - kishte një djalë me emrin Lykaon, i cili themeloi dinastinë e mbretërve të Arkadisë (po te Klausen, fr. 224).

Pasardhësi i Hekateut, **Helaniku nga Lesbosi** (480-400 p.e.s.) në fragmentin e tij 76 numëron disa mbretër pellazgë: Frastorin, Amyntorin, Teutamidin (të cilin e përmend edhe Homeri si Teutames) dhe Nasasin: ishin mbretër që sundonin zonat e Thesalisë dhe të Peloponezit. Si pasardhës të pellazgëve Helaniku sheh etruskët, të cilët edhe te Sofokliu paraqiten si tyrsenoi-pellazgë (Hellanicus, Sturz & Canteri, 1826, ff. 108-109).

Nga etruskologjia e sotme, e cila aktualisht është ngritur në një disiplinë shkencore, mësohet se etruskët nuk janë mit, por realitet. Edhe Helaniku mund të pranohet si dëshmitar i kohës, pasi në këtë hapësirë kohore etruskët përbëjnë një

perandori e cila në mënyrë të vijueshme gjendet në luftë - Beteja e Cuames 474, Lufta kundër Samnitëve 430, Lufta me Romën 406 etj. (*Weltgeschichte*, dtv. München, v. i aktualizuar 3, 2010, f. 73). Që nga Mesjeta e vonë deri më sot janë gjetur dhe janë studiuar një numër i madh artefaktesh arkeologjike dhe linguistike që kanë të bëjnë me epokën e etruskëve (po aty). Në vitin 2007 Universiteti i Torinos u bëri një hulumtim gjeneve të elementeve etruske dhe erdhi në përfundimin se etruskët ishin të ardhur nga Lydia antike. Etruskologu **Guido Barbujani**, i cili gjenotipin e studioi në mënyrë krahasuese, konstatoi që një e treta e aleleve mitokondriale (kjo në fushën e hulumtimit të gjeneve përcakton formimin e një gjeni, i cili gjendet në një vend të caktuar në kromozom, ndërsa përmes variacioneve në bazën e analizës së gjeneve krijohen forma të ndryshme) janë të njëjta me ato të popullsisë anadollake (Barbujani, *Die Etrusker - eine populationsgenetische Studie*, në Günter Hauska Hrsg., *Gene, Sprachen und ihre Evolution*, Regensburg Universitätsverlag 2005, f. 185.). Shpërnguljen e etruskëve nga Azia e Vogël për në Itali gjeoarkeologu **Eberhard Zangger** e shpjegon me krizën politike të shek. XII në Azinë e Vogël, e cila u shkaktua nga përmbysja e shumë mbretërive në fund të epokës së bronzit (Zangger, *Ein neuer Kampf um Troia. Archäologie in der Krise*, Drömer-Knauer, München 1994).

Pa dyshim që **Helaniku nga Lesbosi** nuk ia qëllon rreth prejardhjes së etruskëve, por jo edhe Herodoti, i cili tregon një histori që nuk bie ndesh aspak me përfundimet e **Barbujanit** dhe **Zanggerit** (Herodot, *Historien*, 1, 94, Alfred Kröner Verlag, Stuttgart

1971, f. 48). Përkundrazi, nga studimet e reja kundërshtohet teza e hulumtuesit gjerman të pellazgëve Eduard Meyer (Meyer, *Geschichte des Altertums*, v. 5, Berlin 1884-1902 si dhe ribotime të shumta), i cili historitë e Herodotit i gjykonte si gjysmëfiktive ngaqë ai shkruan për një qytet Kresto në vend të Kroton, qytet i cili nuk duket të ketë ekzistuar ndonjëherë, ndonëse arkeologu dhe profesori Richard Lepsius qysh në vitin 1842 mund të argumentonte se Herodoti flet për qytetin Kroton në Umbrie, pra aty ku në të vërtetë jetonin pellazgët (Lepsius, *Über die Tyrrhenischen Pelasger in Etrurien und über die Verbreitung des italischen Münzsystems von Etrurien aus*, Georg Wigand Verlag, Leipzig 1842, f. 3).

Herodoti e tregon historinë e pellazgëve kështu: Në Librin e tij të parë, fragmenti 57, pranon që nuk e njeh gjuhën e pellazgëve, sepse pellazgët qenë fqinjët e drejtpërdrejtë të dorëve dhe banonin Thesalinë, Plakinë dhe Skylakën dhe se shumica e tyre ishin bërë (asimiluar) helenë. Po aty, në fragmentin 146, ai replikon kundër hamendjeve që jonët qenkëshin “gjak i pastër” dhe numëron një numër popujsh që banonin në qytetet jonike e, në mesin e tyre, edhe akadianët pellazgë. Për të theksuar edhe më tej procesin e përzierjes së popujve dhe kulturave të atëhershme, në Librin e dytë të tij Herodoti shkruan se e shumta e emrave të Zotave të helenëve ishin me prejardhje egjiptiane dhe pellazge. Në Librin e katërt Herodoti flet për një konflikt në mes të pellazgëve dhe argonautëve, gjatë të cilit të parët i dëbojnë të dytët nga Lemnosi. Pas një kohe edhe vetë pellazgët dëbohen nga Lemnosi dhe Imnosi prej persit Otanes, sikurse thotë Herodoti në Librin e pestë, fragmenti 26. Në Librin e gjashtë,

fragmenti 136, pellazgët përmenden në kontekst të një procesi gjyqësor kundër Miltiadit. Si rrethanë lehtësuese mbrojtësit përmendin luftën heroike të Miltiadit në betejën e Maratonës kundër pellazgëve. Në Librin e shtatë, fragmenti 97, Herodoti përmend Joninë (venbanimi i jonëve ishte para së gjithash Greqia Qendrore - Atika me Athinën e mëvonshme dhe Eubea). Në Librin e tij të tetë, fragmenti 44, Herodoti thotë se Helasi (Helas rrjedh nga emri i fisit të Thesalisë jugore dhe nga emri i qytetit jo larg nga Farsalës, te Homeri si Distrikt Phthia stërgjyshi i të cilit ishte Hela) më herët kishte qenë në duart e pellazgëve (Herodot, *Historien*, I fr. 56, fr. 146; II fr. 50; IV fr. 145; V fr. 26; VI fr. 136; VII fr. 94; VIII fr. 44).

Për Ilirinë dhe ilirët Herodoti flet shumë pak, por me aq qartësi sikur bashkëkohësit e tij ta dinin saktësisht se për cilin vend është fjala. Kur ai, pas udhëtimit të vet, provon t'i përshkruajë doket e asirasve, i krahason doket e tyre me ato të fqinjëve të tij ilirë. Në përpjekjen e tij për të skicuar një gjeografi të Skithisë ai përmend edhe lumin Angros, i cili atje rridhte nga Iliria. Në Librin e tij të tetë, fragmentin 137, Herodoti tregon historinë e ikjes e tre vëllezerve Gauan, Aerop dhe Perdik, të cilët përmes Ilirisë arrijnë në Maqedoninë e Epërme (linguistët dhe shkencëtarët e gjuhësisë si Otto Hoffmann, Ivo Hajnal, Hermann Bergston dhe të tjerë i rendisin maqedonët ndër fiset greke, të cilët ishin të veçantë pasi qenë përzier me ilirët dhe trakët) (Herodot, *Historien*, I fr. 196; IV fr. 49; VIII fr. 137; IX fr. 43).

Për dardanët Herodoti flet në Librin e tij të parë, të pestë dhe të shtatë. Kur përshkruan vendin e quajtur Dardanos, i cili përshkohet nga mbreti pers Kir gjatë

pushtimeve tij në Babiloni, pa dyshim që e ka fjalën për qytetin në bregun aziatik të Turqisë së sotme, Helespontin, përkatësisht për provincën Çanakkale, ku më vonë edhe ndodhi beteja e famshme e Galipolit. Për të njëjtët dardanë lexojmë edhe te **Tukididi** (8.104) (Thukydides, *Der Peloponnesische Krieg*, Düsseldorf 2002). **Straboni** (13, 1, 28) tregon se si gjatë luftës në mes të romakëve dhe Antiohisë dardanët e Helespontit iu bashkuan romakëve. Për çka banorët e qytetit Dardanos mandej u shpërblyen nga Roma me statusin *civitas libera*, gjë që mund të lexohet edhe te **Tit Livi** (38, 39, 11) (po aty, I fr. 189; V fr. 117; VII fr. 43).

Edhe historianë dhe gjeografë të tjerë të kohës antike, si **Efori, Dionisi, Pausiani** përsërisin të njëjtën teori pellazge që fillimisht gjendet te Homeri dhe Herodoti. Mirëpo konstatohet se asnjë poet, shkrimtar tragjedish dhe gjeograf i Antikës së hershme e të vonë nuk na jep asnjë arsye - madje as edhe asociative - që pellazgët të kenë ndonjë lidhje me ilirët, maqedonët ose grekët. Një ndërlidhje e tillë ekzistonte, porse me dardanët e Dardaneleve të Ilionit dhe jo me të tjerët. Buxhovi me qëllim ndërron emrin Dardanos me fisin e dardanëve (që nuk luanin ndonjë rol më herët), i cili jetonte në periferi të Ilirisë jugore dhe më vonë themeloi edhe mbretëritë e veta. Deri më sot nuk ka asnjë indicie që do të konfirmonte fatin e pellazgëve në njëërën ose tjetrën fazë të historisë. Ndërtimet cikloprike, që Buxhovi i paraqet si specialitet pellazg (libri 1, f. 66.), janë arkitekturë dhe formë vendbanimi karakteristike të kohës së vonë të bronzit në Transkaukaz (1500-780), siç na dëshmojnë arkeologët dhe historianët Reinard Bernbeck dhe Philip L.Kohl (Bernbeck, *Politische Struktur und Ideologie in*

Urartu. Archäologische Mitteilungen aus Iran und Turan 35/36, ff. 267-312; për kohën e vonshme të hekurit edhe Kohl, *Migrations and Cultural diffusions in the later Prehistory of the Caucasus*, në Ricardo Eichmann/ Hermann Parzinger Hrsg., *Migration und Kulturtransfer*, Habelt, Bonn 2001, f. 324).

“Argumenti” mitologjik i Buxhovit

Mitet që në studimet mbi mitologjinë antike njihen si *cikli tebanik* (Kerényi, Karl, *Die Mythologie der Griechen*, dtv. München, 22. Auflage, 1960/2008.) në librin e Buxhovit transferohen si botë mitologjike pellazgo-dardane (libri 1, ff. 57-65.). Pohimet e tij mbështeten në dy indicie: 1) Herodoti pohon që helenët i kanë Zotat e tyre nga egjiptianët dhe pellazgët dhe 2) Biri i Kadmit dhe Harmonies quhej Illyros, ky i fundit themeloi Ilirinë. Llogaria duket mjaft e thjeshtë dhe logjike. Megjithatë nga kultura oborrtare e epokës mikeno-mionike, nga Teba në Boeti, aty ku gjeneologët i gjetën këto tregime mitologjike (750-500 p.e.s.) të shkruara në heksametrin daktilik të greqishtes së vjetër, kanë mbetur rrëtime dhe mbishkrime që tregojnë një histori krejtësisht tjetër dhe të veçantë, duke rrëzuar kështu çdo autoritet të miteve për të shërbyer si argumente shkencore. Ato nuk shërbejnë gjithaq kur orvatemi të bëjmë rikonstruimin e identitetit kulturor të fiseve (Kerényi, po aty, ff. 7-42). Përse?

Kadmoi - babai i Illyrosit - ishte i biri i Agenorit dhe mbreti më i madh i Tebës. Përtej botës së legjendave, sidomos atyre me kuçedrën dhe themelimin e Tebës (të cilën Buxhovi e integron në sqarimin e tij të miteve pellazgo-dardane), ekzistojnë qindra

gjetje që nxjerrin në dritë historinë e këtij rajoni në mënyrë më të faktuar duke rikonstruktuar përmasat religjioze të kohës. Në një numër të madh tabelash lineare B gjenden mbi njëqind vula asirike nga shekulli XIII, që argumentojnë varësinë e Tebës nga mbretërit e Mesopotamisë.

Shumica e hetitologëve nisen nga fakti se tebanët janë pjesë e diasporës së mbetur nga invadimet e hershme të ardhura nga rajoni i lumit Tigris. Ky supozim përforcohet edhe më për shkak të luftërave të vazhdueshme të Tebës kundër Athinës dhe për përkrahjen e vijueshme që tebanët u bënë asirasve, persëve dhe perandorive tjera të Azisë Qendrore dhe Anadollit (S. Deger-Jalkotzky, O. Panagl (Hrsg.): *Die neuen Linear B-Texte aus Theben*, në "Akten des internationalen Forschungskolloquiums an der Österreichischen Akademie der Wissenschaften am 5. und 6. Dezember 2002", Wien 2006). Domethënëse në këtë mes janë letrat e përmbledhura në alfabet pykor dhe në një hetitishte të çalë, të cilat i drejtoheshin mbretit hetit *Hattušili II*. Hetitologu dhe orientalisti në zë Frank Starke i dëshifroi ato si raporte të tebanëve për mosmarrëveshjet e tyre me ishujt e tjerë të Egjeut verior që rreth çështjes së Trojës. E shumta e letrave përmbajnë emrat e Kadmit dhe të Etoklit (Starke, *Die keilschrift-luwischen Texte in Umschrift*, Harrassowitz, Wiesbaden 1985).

Nga kjo gjendje e fakteve, krahasuar me historinë e rikonstruktuar të Buxhovit, rezulton një përfundim logjik që historianit kosovar afërmendsh nuk do t'i pëlqejë fare:

Kadmi fillimisht ishte mbret hetit. Duket sikur - sipas autorëve antikë që i citon edhe Buxhovi - edhe pellazgët dhe të tjerët ta kenë pranuar Kadmin si mbret/zot

të tyre.

Është e sigurt që hetitët ishin një popull i Azisë së Vogël, që jetonte në Sirinë dhe Palestinën e sotme.

Është e sigurt që tebanët korrespondonin në gjuhën hetite, madje edhe atëherë kur greqishtja vlente si “gjuhë universale” e rajonit. Së këndejmi edhe epiteti “barbar” i Herodotit për pasardhësit e hetitëve, të cilët nuk e flisnin greqishten. Sipas kësaj sage, Illyros është biri i Kadmit dhe i gruas së tij Harmonia (ose Niobe, varësisht nga forma e recipimit).

Illyrosi themeloi mbretërinë me emrin Iliria.

Conclusio: Pra, ilirët, dardanët, përkatësisht shqiptarët dalin si (ashtu si edhe pellazgët, pasi Kadmi ishte edhe babai i Pellazgosit) etni me prejardhje hetite, përkatësisht siriko-palestineze.

Këtu ne nuk dëshirojmë të shumëzojmë edhe më tej spekulimet lidhur me prejardhjen e ilirëve, pellazgëve, trakëve etj., por vetëm po përdorim formulën zenonike të paradoksit për të tërhequr vëmendjen në kontingjencën (kontingjencë - nga logjika - formë e dëshmisë e cila siç mund të jetë e saktë, mund të jetë edhe e gabuar) që përmbajnë shumica e teorive që përpiqen të dëshmojnë prejardhjen etnogjenetike të popujve në bazë të arsenalit mitologjik.

Shkencëtari i letërsisë Hanjo Kesting solli, para pak kohësh, një analizë të mrekullueshme krahasimtare të teksteve më të vjetra të qytetërimit (Kesting,

Grundschriften der Europäischen Kultur- Antike, Mittelalter, Renaissance und Neuzeit, 3 Bde, Wallstein Verlag, Göttingen 2012). Në librin e tij të parë mbi Antikën, gjatë krahasimit të Epit të Gilgameshit, veprave të Homerit, Biblës dhe autorëve të tjerë deri te *Germania* e Tacitit, ai në mënyrë tejet koncize ka dëftuar se si mitet dhe ndodhitë mitike të botës mesopotamike të Gilgameshit mund të gjenden edhe te veprat e Homerit, te Bibla, te Eskili, te Sofokliu, te Platoni, te Virgjili, tek Ovidi e kështu me radhë. Zotat në mënyrë vijueshme ndryshojnë emrat, gratë dhe fëmijët e tyre, ndërsa narrativja mbetet gjithnjë e njëjta (po aty, libri 1 mbi Antikën). Madje edhe Herodoti tërhiqte vëmendjen se ka pasur zhvendosje mitesh në mes të popujve dhe fiseve. Nga historia e kulturës së Antikës dimë që bota e Zotave dhe të të ashtuquajturave vende të shenjta shërbente si pikëtakim për grupe të ndryshme gjuhësore dhe kulturore. Asokohe - kur nuk ishte e pranishme ideja e kombit, e etnisë - dyndjet e popujve, përzierjet, lidhjet dhe asimilimi ishte një normalitet shumë më i fortë se më vonë (Bringmann, Klaus, *Kulturgeschichte der Antike*, München 2011, ff. 139-141).

20

Termet kryesorë *helenë* dhe *barbarë*, që Buxhovi i përkthen si *ilirë* dhe *grekë*, në fjalorin e autorëve antikë nuk kishin asnjë kuptim tjetër përpos se për të dalluar njerëzit në greqishtfolës dhe jogreqishtfolës. Në historinë e Apostujve (6.1) edhe hebrenjtë që jetonin atje quheshin si helenë (Thompson, *Studien-Bibel*, ribot. i reviduar 1984). Hebrenjtë - sikurse dihet - nuk kishin të bënin asgjë me religjionin dhe kulturën greke. Madje si barbarë janë etiketuar edhe vetë grekët që nuk zotëronin pa gabime

gjuhën greke, pra të tillë nuk janë quajtur vetëm “fiset e prapambetura” dhe brutale, që kundërshtonin t’i dorëzonin armët në portat e Polisit (Todorov, Tzvetan, *Die Angst vor den Barbaren*, Hamburger Ed. 2011, ff. 28-28), por të gjithë ata që nuk flisnin gjuhën e Homerit.

Përveç të gjitha problemeve të cekura më lart, për sa i përket rolit të miteve në identifikimin e kulturave të veçanta, as në interpretimin mitologjik nuk ekzistojnë nje familjare e kombinacione që do t’i lidhnin konkretisht e qartë pellazgët me ilirët ose hetitët, etruskët, ose tebanët me dardanët ose ilirët. Mitologjia si e tillë duket sikur t’u ketë takuar të gjithëve. Secili popull i ka interpretuar e përdorur mitet sipas nevojave të veta. Shkenca e mitologjisë deri më sot nuk ka mundur të thotë (dhe duket mjaft vështirë se do të sqarojë diçka edhe në të ardhmen) se kujt i ka takuar ky Zot dhe kujt ai tjetri, ashtu siç thotë arkeologjia sot se në Europën juglindore kanë jetuar një numër i madh kulturash, religjionesh dhe popujsh, të cilët në mënyrë koalicionesh formonin rajone dhe mbretëri për të mbijetuar nëpër kohë dhe situata. Prandaj me plot të drejtë profesori dhe specialisti i Europës juglindore nga Mynihu Edgar Hösch e formulon kështu tezën e tij: “Përzierja irrituese etnike e Europës juglindore është rezultat i proceseve asimiluese ndërmes popujve autoktonë dhe dyndjeve që kanë ndodhur vazhdimisht e përgjatë shekujsh” (Hösch, *Geschichte der Balkanländer*, C. H. Beck Verlag, München, 2. Aufl. 1993, f. 21).

Historia e Antikës romake (Huttner, Ulrich, *Römische Antike*, Attempto Verlag, Tübingen 2008) dhe ajo e Antikës së vonë (Demandt, Alexander, *Geschichte der*

Spätantike - Das Römische Reich von Diokletian bis Justinian, C. H. Beck Verlag, Aufl. 2, 2008) sjellin argumente të mjaftueshme për të vërtetuar se parimi ligjor romak “*Dum nullum fastiditur genus, in quo eniteret virtus, crevit imperium Romanum*” (shqip.: “ngaqë askush nuk u përjashtua për shkak të prejardhjes dhe ajo (Roma) pranoi çdo njeri të zellshëm, u rrit Perandoria romake” (Demandt, po aty, f. 288.) i ka rrënjët qysh më herët, në perandoritë madje edhe të shekullit XX p.e.s, si në Orient ashtu edhe në Oksident (po aty).

Çështja Ilire

Historiografi i sotëm është i detyruar që edhe strukturat organizative politike e kulturore të mbretërive ilire dhe dardane t’i vështrrojë në këtë kontekst. Posaçërisht në ilirologji kjo lloj perspektive është me rëndësi kapitale, sepse përdërisa të grekët dhe romakët mund të fiksohen disa karakteristika kulturore-identitare, të figurat sunduese ilire kjo gjendje është shumë më komplekse dhe, pra, më spekulative (N. G. L. Hammond, *Illyrians and North-West Greeks*, në CAH, V. I2 1994, 427 f.; J. Morris, *Archaeology and Archaic Greek History*, në N. Fisher, H. Van Wees [s. o. A. 2] 40 f.; 50; 57). Studiuesi i Antikës i vdekur në vitin 2001 Nicholas Geoffrey Lemprière Hammond përshkruan raportet e brendshme të Ilirisë si një konglomerat bashkësisht fisnore dhe popujsh (*koinons*), të cilët zinxhirin e urdhrave mbretërorë i pranonin vetëm në kohëra lufte, atëherë kur viheshin në rrezik burimet e tyre ekonomike (po aty). Në të njëjtat rezultate del edhe arkeologu gjerman i Mesjetës së hershme dhe

botuesi i Leksikonit Real të Antikës gjermane Heiko Steuer, i cili shkruan se në Iliri mbreti kishte kompetencë vetëm në kohëra lufte përderisa në kohë paqeje zotëronte një “liri, një an-arki në kuptimin më burimor të fjalës” (Steuer, *Hauptling, Hauptlingstum*, Artikel në: “Reallexikon der Germanischen Altertumskunde”, 13 (1999) 291-31, 1 298 f.). Pierre Carlier në studimin e tij “*Rois illyriens et roi des Illyriens*” i ka konfirmuar edhe më bindshëm këto rezultate duke shpjeguar se pikërisht kjo mungesë e fakteve materiale është arsyeja se përse mbi perandoritë mbretërore ilire ekzistojnë aq pak fakte (me përjashtim të disa monedhave në greqishte dhe latinishte), gjë që pamundëson krijimin e një historie më pak spekulative rreth rolit të ilirëve në kohë të caktuara (Carlier, *Rois illyriens et roi des Illyriens*, në “*Ill*”. I [s. o. A. 1] 39-46, N. G. L. Hammond, *The Illyrian Kingdoms, circa 400 – 167 B. C.*, ABSA 61, 1966, 239-253)

Paradigmat dhe mungesa e fakteve

Përkundër kësaj faktologjie gati inekzistuese (një ankesë e ardhur kryesisht nga arkeologët) në ilirologji ka një paradigmë e cila përfaqësohet nga shumë shkencëtarë seriozë, në mesin e tyre edhe historianë me zë të kohës, si Peter Bartl, Peter Jordan, Klaus Steinke, Wilfried Fiedler, Walter Raunig, Noel Malcolm, Edgar Hösch, Karl Kaser, Wolfgang Zeitler, Joachim Matzinger, Stefan Troebst etj. Ky ekip hulumtuesish nuk përmendet fare në historiografinë e Buxhovit, ngase këta vijimësinë e shqiptarëve të sotëm nga ilirët e paraqesin vetëm si të mundshme (kontingjente - e mundshme ose jo). Në historiografinë e Buxhovit për ilirët, dardanët dhe shqiptarët paraqitet vetëm

doktrina shtetërore nga “Historia e Popullit Shqiptar” (Akademia e Shkencave, Toena, Tiranë 2002), e shoqëruar me citatet e tjetërsuara të Peter Bartl-it, Stadtmüller-it dhe shkencëtarëve të tjerë të variantit të kontingjencës. Buxhovi nuk përmend në listën e burimeve Michael Wheitmann-in (*Balkanchronik*), historiani aktual që është në po të njëjtën linjë me të dhe me historinë zyrtare shqiptare. Burim kryesor (madje edhe duke e keqpërdorur, siç do të shihet te çështja dardane) të dy librave ka vetëm *Historinë* zyrtare.

Dardania - trake apo ilire?

Grupin tjetër të shkencëtarëve, të cilët e përjashtojnë teorinë e prejardhjes ilire së shqiptarëve, Buxhovi e denoncon si propagandues të historiografisë serbe; në fakt historiografia serbe bën gjithçka që shqiptarët t’i lokalizojë si të ardhur nga Kaukazi ose Palestina, çfarë edhe Buxhovi e bën padashje me argumentet e tij mitologjike. Buxhovi e hesht faktin se kjo teori që i identifikon shqiptarët si pasardhës të trakëve rrjedh nga linguistët me famë botërore, si Gustav Weigand, Georg Solta, Françoise Bader, Claude Brügger etj. Për ne mjafton vetëm të dimë të lexojmë për të parë se këta autorë nuk janë serbë. Edhe pse Buxhovi përjashton tezën trake, ai si duket “pavetëdijshtëm” bëhet përkrahës i saj. Si?

Për arsye se Buxhovi Dioklecianin dhe Justinianin i paraqet si figura që sigurojnë vijimësinë e traditës pellazgo-iliro-dardane, mbretër të cilët kontribuojnë që Dardania të ngrihet në djepin e fundit dhe më me rëndësi të kulturave antike. Me këtë Buxhovi *in silentio* provon të ushqejë tezën e supremacisë kosovare ndaj trojeve të tjera shqiptare.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës shtresa të caktuara intelektualësh kosovarë, në favor të krijimit të një identiteti të veçantë, orvaten që famën e Ilirisë ta bartin nga Dalmacia dhe Adriatiku shqiptar i Durrësit – në të njëjtën mënyrë si edhe ilirologët modernë slloveno-kroatë – dhe ta zhvendosin në Kosovën e sotme. Me këtë Buxhovi rreket të vërë në lëvizje një rikonfigurim të vetëdijes panshqiptare, e cila nuk do ta absorbonte më Shqipërinë si “mëmëdhe”, si deri më tani, por Kosovën. Një strategji identike me atë të serbëve, të cilët dëshirojnë ta stampojnë Kosovën si “djep të kombit serb” (Buxhovi, Kosova, libri I, ff. 235-499).

Të kthehemi te “mbretërit pellazgë, ilirë dhe dardanë Diokleciani, Konstantini dhe Justiniani” të Buxhovit.

Në 30 vitet e fundit janë bërë studime të panumërta për figurat qendrore të perandorive romake. Në këtë kuadër edhe shumë monografi shkencore mbi tre mbretërit e lartpërmendur. Në mënyrë të akumuluar i gjejmë rezultatet në studimin e profesorit të Historisë së Vjetër në Institutin Goethe të Frankfurtin mbi Main, Hartmut Leppin. Libri i tij “Justiniani - eksperimenti i krishterë” vlen si libri më i mirë dhe më i saktë ndër monografitë e botuara deri më tani për Justinianin.

Çfarë shkruan Leppin-i?

Justiniani, përkatësisht Petrus Sabbatium, siç ishte emri i tij i vërtetë, rrjedh nga prefektura Illiricum, nga rajoni mes Scupi dhe Naissus (sot Nish dhe Shkup). U lind në vitin 482 në Tauresium, Maqedoni e sotme. Për shkak të prejardhjes së tij

bashkëkohësit e e quanin *Traku*. Siç thërrisnin edhe Dioklecianin, Konstaninin e Madh dhe Valentianin, sepse që të gjithë kishin të njëjtën prejardhje. Justiniani kishte vëllezër dhe motra, mes tyre edhe një motër me emrin Vigilantia. Justinianin prindërit e tij e pagëzuan sipas perëndisë trake Sabatius. Emër që ai e fshihte me qëllim për të bërë karrierë ushtarake në Perandorinë romake. Për shkak të dialektit të tij trak, ai fliste një greqishte të çalë, por për ta shkruar e shkruante atë në mënyrë të përkryer, siç vërtetohet nga letërkëmbimet e tij (Leppin, *Justinian - das christliche Experiment*, Klett-Cotta Verlag, Hamburg 2011).

Të marrim për ndihmë silogjistikën aristoteliane:

Fjalja e sipërme: Justiniani ishte trak. Kishte emër të zotit trak Sabatius (një zot i përafërt me Dionisin). Se çka ishin stërgjyshërit e tij (pellazgë, hetitë apo diç tjetër) nuk mund të argumentohet. Është e sigurt që nuk ishin ilirë, sepse në kohën e tij njëkohësisht jetonin edhe fise të tjera të njohura si ilire. Në të kundërtën, ai në burimet e kohës do të thirrej “Iliri” dhe jo “Traku”. Logjike, apo jo?

Fjali e poshtme: Ai fliste trakisht dhe një greqishte të çalë, por shkruante shumë mirë në të dyja gjuhët. U bë perandor i Perandorisë romake dhe e krishteroi atë.

Konkluzioni: Justiniani nuk mund të ketë qenë pellazg dhe as ilir. Dardan ishte me siguri, sepse jetonte në provincën autonome historike të Dardanisë, e cila ndodhej nën sundimin romak, provincë ku jetonte një përzierje e fiseve, popujve dhe kulturave të ndryshme.

Me të njëjtën formë silogjike mund të vepohet edhe me dardanët e tjerë të

Buxhovit. A ishin dardanët trakë dhe të fundit apo të parët shqiptarë? Edhe teza e vjetër e Weigand-it nuk mund te merret seriozisht, sepse Dardania nuk kishte një strukturë homogjene kulturore. Weigand-i mund të mos ketë të drejtë, por Buxhovi aq më pak, sepse ai në mënyrë të tërthortë e konfirmon Weigand-in duke dashur në të njëjtën kohë të mbetet "ilir". Kundërshtitë në librin e Buxhovit janë të panumërta. Praktikisht secilën tezë të tij, po në këtë mënyrë, mund ta trajtosh deri *ad absurdum*.

Dallimi në mes tezave dhe parullave

Po shohim se në literaturën antike (që nga Homeri e deri te Ovidi) nuk ekziston as edhe një referencë që do të mbështeste, qoftë edhe për së afërmi, tezën pellazgo-ilire të Buxhovit. Asnjë nga shkruarit antikë të historisë dhe gjeografisë (që nga Herodoti, Tukididi, Straboni, Titusi e deri tek Pausania) nuk i sjell pellazgët në një lidhje me ilirët e aq më pak me dardanët. Mitologjia nuk tregon gjë tjetër përpos faktin që Zotat dhe format e tjera fiktive ishin migruer të përjetshëm nëpër popuj e kultura. Mitologjia mbetet një letërsi e bukur, një botë përrallash të cilat na i ka përsëritur prifti Gustav Schwab duke na i bërë edhe më të bukura, por ajo - tradita mitologjike - nuk mund të keqpërdoret asesi për të rikonstruktuar ideologji të reja identiteti. Ne kemi mbërritur në përfundim se rezultatet e reja shkencore nga linguistika, arkeologjia, historia e dyndjes së popujve, antropologjia, etnologjia dhe së fundmi edhe analiza e ADN-së flasin kundër mozaikut të hipotezave të Buxhovit, por edhe kundër doktrinave të shumta rreth autoktoniteteve që shpërndajnë historiografitë e Europës Juglindore.

Çka mbetet më e qëndrueshme në tezat e Buxhovit?

Si duhet ta kuptojmë konstatimin e Buxhovit se autorët antikë, me fokusimin e tyre te pellazgët dhe vlerat e tyre si paraardhës të helenëve, i kanë hedhur përtokë të gjitha teoritë joshkencore të filohelenëve?

Cilët autorë antikë?

Ata të cilët ne posa i trajtuam dhe mbi të cilët duhet të ketë ndërtuar Buxhovi teorinë e tij, thonë krejtësisht diçka tjetër. Pikërisht për këtë shkak u hodh poshtë nga ilirologët, specialistët e Antikës dhe të tjerë edhe teoria pellazge e Hahn-it. Për shkak se ajo është një interpretim i pasaktë i teksteve të autorëve antikë. Teza e tij “Dardanët, si të gjithë të tjerët - fise ilire - janë pasardhës të pellazgëve”, si dhe të gjitha tezat tjera në librin e parë, janë për tu refuzuar si parulla të konotuara ideologjike dhe joshkencore.

28

Njëqind vjet keqkalkulim

Historiani romak Amian Marcelini (330-400) shkruante: “Fara e gjithë të këqijave dhe zanafilla e katastrofave të shumta [...], siç kam kuptuar unë, kishte këtë shkas:

popullin e hunëve [...]” (Ammianus Marcellinus, *Römische Geschichte von Wolfgang Seyfarth*, Berlin 1968–1971, në “Schriften und Quellen der alten Welt” 21, 1–4).

Buxhovi pohon të kundërtën: Ishin sllavët ata që në shekullin VII e mallkuan Europën duke e ndarë në Lindje dhe në Perëndim. Nga të gjithë pushtuesit, “sllavët ishin më barbarët”, thotë autori (libri I, ff. 330-350). Si burim referues për këtë pohim

Buxhovi paraqet librin e Noel Malcolm-it "Kosovo a short History» (Pan Books 2002). Por, në faqet e cituara (23-42) të Malcolm-it dhe të autorëve të tjerë (Jireček, Ostrogorski), të cilat Buxhovi i përdor si referenca, sllavët nuk paraqiten "më barbarë" se hunët, avarët dhe ekspansionistët e tjerë. Afërmendsh, të gjithë ishin brutalë, pra edhe sllavët (Malcolm, *Kosovo*, ff. 22-23). Do të ishte edhe e dyshueshme sikur Malcolm-i të pohonte diçka të tillë, sepse në 50 vitet e fundit (pas Jirečekut, Ostrogorskit dhe Shevill-it të viteve 20 dhe 40 të shekullit të kaluar) janë bërë qindra studime që, përpos tjerash, arrijnë të datojnë saktë valët ekspanduese drejt Europës juglindore. Në këto studime, si edhe te Malcolm-i (po aty, ff. 22-23) dhe Jirečeku (*Historia e serbëve*, ribot. nga Jovan Radoniç, Beograd 2006, f. 46), pushtimi sllav nuk datohet me shekullin VII, siç thotë Buxhovi (libri I, f. 336), por në mesin e shekullit të VI, më saktë në mes viteve 547-550. Po këto data na i sjell edhe profesori i Kings College-it nga Londra Peter Heather me librin e tij "Invasion der Barbaren" (Klett-Cotta Verlag, Stuttgart 2011). Buxhovi keqkalkulon për rreth 100 vjet.

Në këtë kapitull gati pa burime (ose me burime të falsifikuara) ekspandimet e avarëve, gotëve, hunëve të Atilës dhe Udines përkundër edhe burimeve të kohës (p.sh. Olympiodori, Prokopi, Hierokli etj.), jepen si më pak brutale dhe më të parrezikshme se ato të sllavëve barbarë, të cilët në fakt vijnë nga të njëjtat stepa dhe rrethina si edhe kolegët e tyre hunë. Seleksionimi i sllavëve si "më barbarët" dhe fajtorët për shkatërrime nuk është i papritur, mirëpo shkencërisht rezulton i paqëndrueshëm

(Demandt, *Geschichte der Spätantike*, ff. 1-8).

Ndërkaq është gati e qartë që hunët, para se të marshonin për në Perëndim, jetonin në mes të lumenjve Don dhe Vollga në stepat euroaziatike (Rusia e sotme). Për sa i përket prejardhjes së hunëve, shkenca ushqehet me supozime, Disa i shohin ata me prejardhje kineze, disa të tjerë si iranianë turkfolës, ndërsa grupi më i madh i hulumtuesve mendojnë se ishin paraardhësit e proto- dhe vollga-bullgarëve, të cilët më vonë u ndanë më dysh: në fisin e krishterë sllav (protobullgar, shekulli 10) dhe në atë musliman (vollgabullgar). (Jonathan Shepard, *Slavs and Bulgars*, në "The New Cambridge Medieval History", v. 2, Cambridge 1995, f. 228 dhe vij.). Specialistë si Heather, Demandt, Hösch, Malcolm dhe posaçërisht historianët e Historisë Romake Huttner dhe Leppin fajin për shkatërrimin e strukturës së popullsisë dhe tregtisë së Europës juglindore të asaj kohe ua ngarkojnë hunëve dhe avarëve e jo siç thotë Buxhovi parimisht: sllavëve. Në kuptimin lokal dhe në një kuptim të kufizuar kohor Buxhovi ka të drejtë. Në fakt ishin sllavët ata që në vitet 547-548 shkatërruan dhe pushtuan Trakën dhe Ilirinë deri në Epidamn (Durrës). Të trimëruar nga këto fitore, 13000 sllavë marshuan drejt Selanikut. Mungojnë dokumente për të vërtetuar se deri kur mund të merren sllavët si zotërues të trojeve ilire. Por është e sigurt se, që nga viti 602, ndryshon historia kur perandori i hershëm bizantin Maurik i nxiti avarët dhe antët për t'i përndjekur sllavët deri në Dalmaci dhe për të i shkatërruar ata. Diku rreth vitit 604 në Iliri hynë në fuqi sërish rrethanat romake (Heather, Peter, *Die Invasion*

der Barbaren, ff. 364-365.). Më vonë, deri në shek. X, sllavët dhe pasardhësit e tyre ishin të pushtuar nga të tjerët. Vetëm nga viti 950 e këtj historia merr shënim për ekzistimin e tyre, atëkohë kur fiset sllave provuan (dhe dështuan) të organizonin një kryengritje kundër Perandorisë bullgaroperëndimore të Carit Samuel (Hösch, Edgar, *Geschichte der Balkanländer*, ff. 57-5).

Faciti: Përpjekja e Buxhovit për të bërë vetëm sllavët përgjegjës për shkatërrimin e qytetërimit antikoeuropian është joserioze. Sulmet sllave ishin një pjesë e ekspandimeve që ristrukturuan, prishën dhe rikonfiguruan demografinë dhe pluralitetin kulturor të popujve të asaj kohe në Ballkan, mirëpo krahasuar me ato parapraket dhe më të vonat, triumfi i tyre ishte fare i shkurtër dhe i pakrahasueshëm me dhunën e hunëve dhe avarëve.

31

Teoria e Buxhovit mund të kuptohet vetëm nga aspekti kontrafaktik: nëse Iliria me të vërtetë ka qenë çerdhe e qytetërimit antik, atëherë Buxhovi do të kishte të drejtë. Atëherë sulmet sllave do të ishin fajtorë për shkatërrimin e qytetërimit antik të Europës juglindore. E gjitha kjo, afërmendsh, vështruar pra në mënyrë kontrafaktike.

Bibliografia si ilustrim

Lexuesit mund të mbeten të qetë. Ata që kanë lexuar njëherë “Historia e Popullit Shqiptar” mund të lënë anash librin “Kosova - Perandoria osmane”, sepse s’do të humbin gjë. Është një përsëritje e mërzitshme e historiografisë shqiptare. Aty-këtu Buxhovi përmend libra si “Kosovo a Short History” të Malcolm-it, “Crescent and the

Eagle” të Georg Gawrych-it (I. B. Tauris, London 2006) ose atë të Oliver Jens Schmitt-it “Skanderbeg” (*Skanderbeg – Der neue Alexander auf dem Balkan*, Pustet Verlag, Regensburg 2009), por ata ai nuk i përdor vërtet. Ai komenton dhe replikon me “Skënderbeun” e Schmitt-it pa bërë transparente se çfarë ka shkruar Schmitt-i. Asgjë nuk argumenton, por vetëm shkruan se studimi i profesorit nga Vjena nuk qëndron dhe pikë (libri II, f. 71).

Indicie tjetër që flet për huazimin e gati të plotë të veprës “Historia e Popullit Shqiptar” është edhe mungesa e informacioneve dhe dijes nga ana e të dyja palëve. Si “Historia” ashtu edhe Buxhovi shkruajnë për proceset e kohës osmane pa pasur ndonjë ide që vetëm në mes të viteve 2001 dhe 2007 janë botuar së paku 50 studime në anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht, libra që sjellin burime të reja dhe të detajuara dhe që demantojnë interpretimet e shumta të viteve të pasLuftës së dytë botërore deri në vitet *0 të shekullit të kaluar.

32

Historiani pa asnjë burim të 50 viteve të fundit

Vetëm një historian që nuk i ka bërë detyrat e shtëpisë si duhet guxon që pansllavizmin ta reduktojë në një konflikt ruso-osman (Buxhovi, *Kosova*, libri II, ff. 168-175). Pansllavizmi ishte më shumë një program kulturor antiperëndimor (N. J. Danilewskij, *Rusia dhe Europa*, 1880. Iwan Krijewski und Aleksej Chomjakov), i cili mbijetesën e sllavizmit e shihte vetëm përmes shkatërrimit të Perëndimit (të inkurajuar më vonë edhe nga Oswald Spengler). Buxhovi tematizon pansllavizmin sllavojugor dhe

nuk di të thotë se, përpos serbëve, të gjithë sllavët e tjerë nuk ishin vetëm kundër monarkisë Austro-Hungareze dhe osmanëve, por edhe kundër Ruisë, siç mund të lexohet edhe në deklaratën e dalë nga Kuvendi i popujve sllavojugorë të mbajtur në Nish më 7 dhjetor të vitit 1914 (Weithmann, Michael W., *Balkanchronik, 2000 Jahre zwischen Orient und Okzident, Teil III, Pustet/ Styria Verlag, 2. und erweiterte Auflage 1997*).

Vetëm dy burime nuk mjaftojnë

Duke ditur që ekzistojnë disa projekte që merren me rishkrimin e historisë shqiptare mendojmë se një debat edhe më i thellë me veprën “Historia e Popullit Shqiptar”, të prodhuar nga kuzhinat ideologjike të së kaluarës, do të ishte i tepërt, edhe pse vetë debati me Buxhovin është paralelisht edhe debat me “Historinë” e rrëmbyer nga ai. Dy pjesët e para të librit të tretë (ff. 15-455), konform gjithë librave të tij, janë një përsëritje jokritike e “rezultateve hulumtuese” nga autorët e librit “Historia e Popullit Shqiptar” dhe të historiografisë serbe. Të reja këtu janë vetëm dy studime, që kanë të bëjnë posaçërisht me Kosovën në kohën e Jugosllavisë: libri publicistik i Viktor Meier-it “Wie Jugoslawien verspielt wurde” (Beck Verlag, München 1996) dhe libri i edituar nga Dunja Melčić “Der Jugoslawien-Krieg - Handbuch zu Vorgeschichte, Verlauf und Konsequenzen” (Verlag für Sozialwissenschaften, 2. Aufl. Wiesbaden 2007). Në fakt kjo pjesë nuk sjell asgjë të re për hulumtuesit e gjuhëve të huaja, por për historiografinë shqipe po, ngase këtu për herë të parë ka të dhëna për burimet (së paku në bibliografinë e librit të tretë, ff. 911-920), të cilat janë një referencë e mirë sidomos kur

dëshirojmë të dimë se si reflektojnë intelektualët vendorë mbi historinë e shkatërrimit të Jugosllavisë: janë tekste kryesisht korrekte dhe të ndërtuara në bazë të metodologjisë shkencore gjermanofone.

Me gjithë “alergjinë” që ka Buxhovi ndaj hulumtuesve joshqiptarë, atij do t’i ishte dashur patjetër t’i lexojë studimet më të reja të dy instituteve (Instituti i Europës Juglindore dhe Instituti i Historisë së Europës Lindore) në Regensburg dhe Vjenë, nëse me të vërtetë do të dëshironte të kryente një punë shkencore. Në “Albanische Geschichte - Stand und Perspektiven der Forschung” të edituar nga Oliver Jens Schmitt dhe Eva Franz (Oldenburg Verlag, München 2009) janë renditur rezultatet shkencore të autorëve më të rëndësishëm gjermanofonë dhe anglofonë (Matzinger, Schmitt, Schumacher, Koller, Clayner, Fischer, Schmidt-Neke, Pichler, Elsie, Malcolm, Bartl, Hösch), të cilët vlejné si referenca primare për të gjitha universitetet e Europës Perëndimore. Për të shkruar për raportet shqiptaro-serbe pa lexuar gjë nga studimet e Holm Sundhaussen-it (*Geschichte Serbiens. 19.-20. Jahrhundert*, Wien 2007); për të bërë histori për shqiptarët dhe Kosovën pa marrë parasysh studimet e Oliver Jens Schmitt-it (*Kosovo: Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft*, UTB, Köln 2008), Konrad Clewing /Jens Reuter (Hg.) (*Der Kosovo-Konflikt: Ursachen, Verlauf und Perspektiven*, Wieser Verlag, Klagenfurt 2000), Rafael Biermann (*Das Scheitern der internationalen Krisenprävention vor Kriegsausbruch*, Paderborn 2006) dhe shumë autorë tjerë, fare pak mund të flitet për gjasë të një historiografie shkencore, siç pretendon Buxhovi. Shumë më shumë kemi të bëjmë me një polemikë gazetareske me adresatë anonimë.

Buxhovi si burim i vetvetes

“Dosja Jusuf Buxhovi - materialet e LDK-së, kutia 1”, kështu burimi 503 në pjesën e tretë të librit të tij. Kutia ekziston me siguri. Në Arkivin e Beogradit të Jugosllavisë Socialiste me siguri që ka edhe më shumë të tilla: një burim interesant për historianët e rinj, ngase Jusuf Buxhovi është dëshmitar i kohës dhe intelektual jo me pak rëndësi i Kosovës së kohës së Jugosllavisë. Nga 1976 deri 2000 (sipas biografisë së tij në facebook) ai ishte korrespondent i të përditshmes shtetërore socialiste “Rilindja” në Gjermani. Ai është autor i 34 veprave letrare, gjysmëletrare dhe publicistike. Është një nga bashkëthemeluesit e “Lidhjes Demokratike të Kosovës”.

Këto të dhëna biografike të tij nuk duhen shpërfillur. Sepse teksti që ka të bëjë me historinë më të re të Kosovës është hartuar në mënyrë tejet subjektive dhe të njëanshme. Posaçërisht në kapitujt dhe paragrafët ku flitet për demonstratat e 68-s, 81-shit, si dhe për luftën e Kosovës, duhet të kemi mjaft kujdes. Së pari, sepse ai historikisht është vetë i përfshirë (ne nuk e dimë si ka qenë qëndrimi i tij si gazetar në “Rilindjen” shtetërore ndaj ngjarjeve të 68-ës dhe 81-shit, por e dimë që Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë kurrë nuk do të lejonte që në Gjermani të shkonte ndonjë përkrahës i atyre demonstratave), dhe së dyti ai ka anësi partiake lidhur me LDK, të cilën e deklaroi në mënyrë të hapur dhe pranoi se favorizon perspektivën e saj – të LDK, e cila si të gjitha partitë tjera ka interes që gjithçka pozitive t’ia mëveshë vetes.

Fushatat vetërehabilituese

Formulimet i tij si “Themelimi i një partie me orientim të djathtë dhe...” (libri III, 467) tregojnë për nevojën e ngutshme të një gjenerate për rehabilitim (se nga çka duan të reabilitohen pjesëtarët e kësaj gjenerate vetëm mund të spekulojmë, i sigurt është ekzistimi i fenomenit), shtresë njerëzish publikë që duket të ketë një ndërgjegje të grrithur për biografinë e vet në kohën e Jugosllavisë. Paraqitja e themeluesve të LDK me orientim “të djathtë” është një falsifikim tjetër i radhës, kur dihet fakti se shumica e këtyre themeluesve deri atëherë ishin anëtarë, deputetë dhe funksionarë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë.

Motivi i Buxhovit për të ngritur Kosovën historikisht në djep të qytetërimit europian ka dështuar tërësisht. E ashtuquajtura “metodë shkencore” e tij nuk prodhon njohuri, por vetëm stereotipe të reja. Është fjala për një tip të menduari të ngritur mbi gjëmadhat e librit “Historia [zyrtare] e Popullit Shqiptar” dhe që rreket të ikë në një drejtim tjetër ideologjik: në atë të nacionalizmit. Ne shpresojmë të kemi argumentuar se Buxhovi nuk ka punuar në mënyrë aspak shkencore, por ka provuar të tregojë një histori duke keqpërdorur burime dhe duke përvetësuar tekste.

Njerëzit e traumatizuar nga luftërat i adhurojnë këto farë historish dhe intelektualit në këtë mënyrë mund të arrijë edhe pozitën e presidentit. Mirëpo, nëse mendojmë në mënyrë afatgjatë, ai në këtë mënyrë u bën vetëm një shërbim të keq atyre që i besojnë. Posa ata të kuptojnë - dhe do të vijë dita kur ta kuptojnë - se janë mashtruar, do të frustrohen, ngase gjithmonë vlen më mirë të jesh i dëshpëruar një herë

(duke e kuptuar të vërtetën) se sa të jetosh përjetësisht në mashtrim. I tillë rezultoi Buxhovi: ai bëri pjesë ndër ata “historiografë” që thënie e Ernest Renanit “Nuk ka komb pa falsifikim të historisë” e marrin më seriozisht nga sa lejohet.

St. Gallen-Prishtinë, 2012.

E përktheu nga gjermanishtja Blerim CANAJ

***Autorët**

Albert Ramaj, teolog dhe filozof, Drejtor i Institutit Shqiptar të St. Gallen-it
(www.albanisches-institut.ch).

Nuri Bexheti, historian, profesor në Universitetin e Prishtinës dhe udhëheqës i programeve për Histori pranë Institutit Shqiptar të St. Gallen-it.